



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA NË SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2022:194453

Datë: 02.11.2022

Numri i dokumentit: 03599043

P.nr.169/2022

NË EMËR TË POPULLIT

- **GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË SKENDERAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal**, me gjyqtarin e vetëm gjykues Fatos Sejdiqaj dhe bashkëpunëtoren profesionale Sandra Fazliu, duke vendosur në çështjen penale ndaj të akuzuarit S., H., nga fsh...-Komuna Skenderaj, për shkak të veprës-Dëmtimi i të drejtave pronësore të personit tjetër nga neni 332 par.1, dhe par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.06/L-074 (tutje:KPRK), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm PP-II.nr.487/2022, të datës 09.09.2022 (2020:0017851), duke vendosur lidhur me kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimor pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, me datën 02.11.2022, mori këtë :

A K T G J Y K I M

- **PRANOHET** kërkesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm PP-II.nr.487/2022, të datës 09.09.2022, dhe gjykata e jepë këtë :

U R D H Ë R N D Ë S H K I M O R

- **I akuzuari S., H.**, nga babai ...dhe nëna ..., mbiemri i vajzërisë, i lindur me datë në Skenderaj, me numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën fillore, i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike.

- Ë S H T Ë F A J T O R -

- **SEPSE** : Me datë 23.02.2022, në fshatin Kotorr-Komuna Skenderaj, me qëllim që të pengojë realizimin e të drejtës pronësore të tjetrit, me qëllim të pengimit të ushtrimit të drejtave pronësore të tjetrit, ka tjetërsuar një pjesë të pasurisë dhe ka fshehur një pjesë tjetër të pasurisë-sende që i ka në posedim, mbi të cilat një person tjetër ka pasur të drejtën e pengut - hipotekë dhe më këtë i ka shkaktuar dëm atij personi në mënyrën e dhëne me datë 02.02.2018, me NLB Banka, me seli në Prishtinë, ka lidhur marrëveshjen e kredisë nr.K0718/186, me të cilin banka fitoi të drejtën e pengut (hipotekës) mbi traktorin IMT 533,

me numër të shasisë 255481, rimorkio Trepça, kositëse për bari, parmendë, vllaqat dhe korniza, spërkatëse gruri dhe automjet EVEZZZ1GZNE162991, viti i prodhimit 1991, të gjithat në pronësi të të pandehurit, e më pasë i pandehuri e ka tjetërsuar veturën në fjalë dhe i ka fshehur sendet e lartpërmendura, duke penguar bankën nga arkëtimi i dhunshëm dhe duke i shkaktuar bankës dëm në vlerë prej 7.201,67 Euro, i cili i është besuar përmbaruesit privat Atip Mustafa.

- Me këtë ka kryer veprën penale-Dëmtimi i të drejtave pronësore të personit tjetër nga neni 332 par.1 dhe par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

- Andaj, gjykata në bazë të kësaj dispozite ligjore e lidhur me nenet : 4, 38, 40, 43, 69 të KPRK-së, si dhe nenit 365, 450 par.1 dhe par.2 nënpar.2.6, nenit 453 par.1, nenit 463 par.1 dhe 2, nenit 495 par.1 dhe 2 të KPP-së, të akuzuarit i shqipton :

- D Ë N I M M E G J O B Ë -

I.- Në lartësi prej treqind (300.00) Euro të cilën shumë është i obliguar që ta paguajë në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditëve, prej ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II.- Nëse i akuzuari dënimin e shqiptuar me gjobë nuk e paguan në afatin e përcaktuar nga gjykata, atëherë dënimin e shqiptuar me gjobë në bazë të nenit 43 par.3 të KPRK-së do ta zëvendësojë me dënim me burgim, ashtu që një (1) ditë burgim do të llogaritet me njëzetë (20.00) Euro gjobë.

III.- Obligohet i akuzuari që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20.00 € (njëzetë euro), si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumë prej 30.00 € (tridhjetë euro), të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

IV.- Pala e dëmtuar NLB Banka me seli në Prishtinë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregulltë civil.

A r s y e t i m

- Prokuroria Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm në këtë gjykatë me datë 27.05.2022 ka parashtruar aktakuzën PP-II.nr.487/2022, të datës 09.09.2022, kundër të akuzuarit S., H.. nga fsh....-Komuna Skenderaj, për shkak të veprës-Dëmtimi i të drejtave pronësore të personit tjetër nga neni 332 par.1, dhe par.2 të KPRK-së, dhe në bazë të nenit 493 par.1 dhe 2 të KPP-së, ka kërkuar nga gjykata që të akuzuarit t'i shqiptoj urdhrin ndëshkimor-dënim me gjobë pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor, me arsyetimin se janë siguruar prova të besueshme se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

- Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor, gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për dhënien e urdhrit ndëshkimor në kuptim të nenit 495 të KPPK-së.

- Gjykata vlerësoi se në shkresat e lëndës ekzistojnë prova të besueshme për dhënien e urdhrit ndëshkimor të cilat e vërtetojnë faktin se i akuzuari ka kryer veprën penale në fjalë si: Procesverbali mbi marrjen në pyetje të pandehurit-S. H. KT-br.487/22 i datës 16.04.2022, lëshuar nga Policia e Kosovës-Stacioni Policor në Skenderaj, Procesverbali i daljes në teren P.nr.896/2019 i datës 23.02.2022, lëshuar nga Përmbartuesi Privat Atip Mustafa Vushtrri, Kontratë për Kredi për Bujqësi Nr.K0718/186 e datës 02.02.2018, lëshuar nga NLB Banka, filiali në Skenderaj, Marrëveshja mbi Pengun Nr.K0718/186 e datës 02.02.2018, lëshuar nga NLB Banka, filiali në Skenderaj, Konfirmimi i Regjistrimit R-20180205-224 e datës 05.02.2018 lëshuar nga Agjensioni i Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë - Zyra për Regjistrim të Pengut, Kartela e Qarkullimit në emër të S., H., e datës 01.03.2022, lëshuar nga NLB Banka me seli në Prishtinë, si dhe nga vështrimi në shkresat e tjera të lëndës.

- Gjykata duke u bazuar në këto prova të besueshme vërtetoi se me veprimet inkriminuese të të akuzuarit përmbushen të gjitha elementet e veprës penale-**Dëmtimi i të drejtave pronësore të personit tjetër nga neni 332 par.1, dhe par.2 të KPRK-së**, për çka gjykata gjeti se i akuzuari në aspektin penalo-juridik është përgjegjës dhe i shqiptojë dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

- Gjykata në përputhje me nenin 69 të KPRK-së, me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit me gjobë, vlerësoi të gjitha rrethanat në matjen e dënimit, ashtu që Gjykata është e bindur se dënimi i shqiptuar është në proporcion me peshën e veprës penale, përgjegjësinë penale dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, duke vlerësuar se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit, i cili parashihet me nenin 38 të KPRK-së, pasi që një nga qëllimet e dënimit është të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, duke vlerësuar se i akuzuari do të përmbahet nga veprime të paligjshme në të ardhmen.

- Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, gjykata e mori duke u bazuar në nenet 450 par.1 dhe 2 pika 2.6 dhe nenin 453 par. 1 të KPP-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit u morë në bazë të nenit 39 par.3 pika 3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

- Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil është marrë konform nenit 463 par.1 dhe 2 të KPP-së.

- Nga sa u tha më lartë e në kuptim të nenit 365 dhe nenit 495 të KPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË SKENDERAJ
- Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal
P.nr.169/2022 me datë 02.11.2022.

Bashkëpunëtorja profesionale,
Sandra Fazliu

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Fatos Sejdijaj

- **KËSHILLA JURIDIKE** : Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afat prej 8 (tetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi. Kundërshtimi i drejtohet kësaj Gjykate me shkrim apo me gojë në procesverbal të kësaj gjykate. Nëse i akuzuari në afatin prej 8 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nuk ushtron kundërshtim, ky aktgjykim do të merr formën e prerë dhe do të ekzekutohet.